



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2018:030172

Datë: 18.12.2020

Numri i dokumentit: 01354266

P.nr. 102/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA NË DEÇAN, Departamenti i përgjithshëm penal, gjyqtari **Sulltan Dobraj,** e me pjesëmarrjen e sekretares juridike Sabiha Hoxha, në lëndën penale kundër të pandehurit Sh. H.nga fsh.K-....., i akuzuar sipas PTH nga Peja me aktakuzën **PP/II.nr.900/2018 te dt.20.06.2018,** për veprën penale cenim i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve nga neni 200 paragraf 1 të KPK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me dt. 25.11.2020, në prezencën e PTH nga Peja Arlinda Nallbani Gacaferri, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij av.Isa Osdautaj, N. Xh. –përfaqësues i te dëmtuarës, me dt.26.11.2020 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt.**18.12.2020** përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri Sh. H., i lindur me dt..... në fsh.k-, ku dhe tani banon, i biri i M. dhe nënës H. e vajzërisë A., i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

Në baze te nenit 364 paragraf 1 nën paragraf 1.3te KPPK-ës

LIROHET NGA AKTAKUZA

Për shkak se:

Me dt.29.03.2018 në kohë te pacaktuar në rrugën “.....”, pa autorizim dhe në mënyrë të kundërligjshme hynë në objektin e te dëmtuarës-ës, dhe atë në ndërmarrjen NSH. “.....” duke e larguar drynin e vendosur nga kjo e fundit dhe duke zëvendësuar me një tjetër në atë mënyrë qe i pandehuri në objektin e ndërmarrjes në fjale e ka shfrytëzuar deri i njëjti është detyruar përmes procedurave përmbaremore ta liroj të njëjtin, dhe atë sipas vendimit E.Nr. 516/10 nga Gjykata Themelore Peje dega në Deçan, ditën kritike kur zyrtaret - dëshmitaret e-ës kanë provuar që ta hapin derën e hyrjes, kishin vërejtur se dryni i objektit ishte ndërruar, dhe nuk ishte i njëjti që ka vendosur e dëmtuara..

- **me çka kishte për te kryer vepër penale te cenim i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve nga neni 200 paragraf 1 të KPK-së.**

Nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për te cilën akuzohet.

Shpenzimet procedurale penale bijën në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

E dëmtuara me seli në Prishtinë udhëzohet në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

A r s y e t i m

PTH nga Peja me akuzën **PP/II.nr.900/2018 te dt.20.06.2018**, ka akuzuar të pandehurin Sh. H.nga fsh.K-....., për veprën penale cenim i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve nga neni 200 paragraf 1 të KPK-së, ka propozuar të caktohet dhe te mbahet seanca shqyrtimit gjyqësore, të administrohen te gjitha provat e duhura e me në fund i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet në bazë të ligjit si dhe të detyrohet në pagesën e shpenzimeve procedurale-penale.

Gjykata me dt.25.11.2020, ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor, në të cilin shqyrtim gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë.

Me qenë se i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë gjykata ka mbajtur shqyrtimin dhe i ka administruar provat personale dhe materiale.

Dëshmitë e dëshmitarëve

Dëshmia e N. Xh. përfaqësues i te te dëmtuarës, në cilësi të dëshmitarit

Përfaqësuesi i-ës ne cilësi të dëshmitarit në shqyrtimin gjyqësorë ka deklaruar se unë jam në pozitën e zyrtarit të lartë ligjor në njësinë e përfaqësimeve në kuadër të departamentit Ligjorë-zyra qendrore e-Prishtinë.-ja ka në menagjim të gjitha ndërmarrjet shoqërorë i administron dhe i përfaqëson, edhe ndermarrja është nën administrimin e atëherë bjenë në kompetencën tonë, që nga viti 2002 e kemi në administrim, në mars te vitit 2018 i është vendosur çelësi-dryni, dhe në bazë te një raporti është konstatuar se është thyer dryni, po ashtu në korrik te vitit 2018 me një shkresë ju kemi drejtuar të akuzuarit që e kemi kërkuar lirimin e lokalit, sipas rregullave pa lejen tonë nuk ka pasur të drejtë ta heqë drynin, dhe ka pasur mundësi të bëjë kërkesë që-ja të ja jap me qira atë lokal. Tani atë lokal nuk e kanë ne menagjim sepse është privatizuar, dhe asnjëherë nuk ka qen pengës i pandehuri për privatizim te atij lokal.

Deponimi i dëshmitares Hasibe Krasniqi

Dëshmitarja H. K.ne shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se “jam zyrtare për menagjimin për administrim dhe operacione të aseteve të ndërmarrjeve shoqërorë të cilat i ka në menagjim, është nën menagjimin e-ës, ndërmarrja shoqërorë ka qenë bashkimi i disa njësive punuese. Diku ne vitin 2003 është vendosur dryni por nuk jomë e sigurt a është viti 2011 apo 2010, ku është mbyllur objekti, pastaj ka pasur vizita në teren kohë pas kohe, kur ka dashur objekti të qitet në tender për shitje

kemi ardhur së bashku me një zyrtare kadastrale për ta matur objektin, kemi tentuar që ta hapim objektin por nuk është hapur, dryni ka qenë i vendosur por nuk kemi mundur që ta hapim. E kemi shikuar objektin nga jashtë në brendi dhe ka qenë njëjtë sikurse kur është mbyllur me inventar brenda.

procedura e likuidimit të NSH në konkretisht për lokalin që është objekte i kësaj çështje penale është përgatitur dhe është shitur para 3 viteve por nuk e di saktë. Çelësat e këtij lokalit ka pasur-ja. Nga momenti që na janë dorëzuar çelësat dhe është mbyllur lokali e deri në momentin që është privatizuar ai lokal nuk e kemi parë dikën duke punuar në atë lokal. Personi që është i akuzuar nuk e ka penguar procesin e tenderimit apo të privatizimit apo të shitjes së këtij lokalit. Është privatizuar ky lokal.

Në momentin kur nuk u hap dryni jemi kthyer në zyrë dhe e kemi treguar rastin të menagjimenti dhe kemi filluar me hapa procedural që parashihen raste të tilla.

Në pyetjen: se a mund të tregoni gjykatës se a ishte dryni i njëjti që ishte vendosur në momentin e mbylljes së lokalit në vitin 2013 apo ishte dry tjetër dëshmitarja është përgjigjur se “kur është vendosur dryni në vitin 2013 unë nuk kame qenë në vend ngjarje”. Te hyrja ka qenë një si strehe por normal që nuk e ka penguar të reshurat, boren, as shiun. Në vitin 2018 është privatizuar, është bërë pranim dorëzimi i kontratës së shitblerjes por nuk i kujtohet se janë dorëzuar edhe çelësat se bashku me kontrate, nuk kemi pasur asnjë ankese nga pranuesi apo fituesi i asaj kontrate të shitblerjes se nuk po mund ta hapë drynin.

Mbrojtja e të pandehurit në shqyrtimin gjyqësorë

I pandehuri në shqyrtimin gjyqësorë ka deklaruar se: “e kame shfrytëzuar lokalin deri në vitin 2013 kur është mbyllur me vendim të gjykatës dhe ku i është dorëzuar-ës, nga momenti që i është dozuar e deri në momentin që është shitur unë nuk e kame shfrytëzuar atë lokal, rreth atij lokalit pas lufte e kame pas ndërtuar një aneks, e me një vendim të komunës jam detyruar që ta rrënoji dhe e kamë rrënuar atë anekse të ndërtuar rreth lokalit në fjalë, drynat nuk i kame ndërruar por vetëm e kamë hequr pjesën e ndërtuar rreth e rreth.-ja kanë kërkuar nga unë në vitin 2018 që ti heqë sendet por unë ju kamë thënë-ës dhenuk kame ku ti qoi ato sende merrni dhe boni çka të doni.

Fjala përfundimtare e prokurorit të shtetit.

Në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit ka deklaruar se “pas administrimit të provave është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë gjendja faktike si në vijim se i akuzuari Sh. H. me dt.29.03.2018 në kohë të pacaktuar në rrugën “.....” Komuna, pa autorizim dhe në mënyrë të kundërligjshme hynë në objektin e të dëmtuarës-ës dhe atë në ndërmarrjen NSH duke e larguar dryrin e vendosur nga kjo e fundit dhe duke e zëvendësuar në një tjetër, në atë mënyrë që i pandehuri në objektin e ndërmarrjes në fjalë e ka shfrytëzuar deri sa i njëjti është detyruar përmes procedurave përmbartimore të liri të njëjtin dhe atë sipas vendimit E:nr.516/2010 nga Gjykata Themelore në Pejë dega Deçan, dhe ditën kritike kur zyrtaret-dëshmitaret e-ës kanë provuar që ta hapin derën e hyrjes kishin vërejtur se dryni ishte ndërruar

dhe nuk ishte i njëjti që kanë vendosur e dëmtuara e lartcekur, pra me këtë është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale cenim i pa prekshmërisë së banesave dhe objekteve nga neni 200 par.1. i KPRK-ës provat me të cilat vërtetohet kjo gjendje faktike sipas deklaratës së dëshmitares H. K. vërtetohet fakti se dryni i lokalit në fjalë ditën kritike nuk është hapur e njëjta ka qenë aty dhe kanë provuar disa herë ta hapin por ka qenë e pa mundur, nga deklarata e përfaqësuesit të palës së dëmtuar vërtetohet se i akuzuari e ka hequr drynin e ndërmarrjestë cilën e ka shfrytëzuar më parë edhe pse i njëjti ka pasur mundësi të aplikon për leje por që nuk e ka bërë, nga raporti i vizitës në teren vërtetohet se me dt.29,03,2018 zyrtaret katastral H. K. dhe B. K. kanë vizituar asetin pronë e ndërmarrjes në likujdim NSH në, ku sipas dëshmitarëve hyrja në lokalë ka qenë e pa mundur pasi që dryni i vendosur me parë ishte ndërruar me një dry tjetër, me aktvendimin E.nr. 516/10 i Gjykatës Themelore ne Pejë dega në Deçan vërtetohet se objekti i cili gjendet ne rrugënnë kreditorit NTPme seli në, i dorëzohet nën administrim, me aktvendimin e KK-..... të dt. 07,02,2018 obligohet i akuzuari që në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit të largoi tërë mallin inventarin dhe gjerat tjera të luajtshme nga lokali, fotografitë e vendit te ngjarjes na japin një pasqyrë të qartë të objektit në të njëjtat shihet se objekti nuk është liruar nga i akuzuari po ashtu dryni shihet ne gjendje të rregullt pra nuk është dëmtuar nga reshjet atmosferike, se i akuzuari nuk i ka heqë gjë sendet ketë e vërtetoi edhe vete ne ketë shqyrtim gjyqësorë pasi që sipas tij ketë ua kalon zyrtarëve që ta pastrojnë, pra i njëjti nuk ka vepruar sipas vendimit të dt.07,02,2018 KK-....., andaj nga të lartcekurat mbetem në tersi pranë aktakuzës përshkrimi faktik dhe juridik të veprës penale dhe i propozoi gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor pasi që është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se ne veprimet e tij qëndrojnë elementet e veprës penale të përshkruar si me lartë.

Fjala përfundimtare e përfaqësuesit te autorizuar të dëmtuarit

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit në fjalën përfundimtare deklaroi se: parashtrori kërkesë pasurore juridike të cilën do ta realizojmë në kontest civil.

Fjala përfundimtare e mbrojtësit te të pandehurit

Av. Isa Osdautaj në fjalën përfundimtare deklaroi se: “nga materialet e tubuara provuese te siguruara nga stadet e ndryshme të procedurës penale të kësaj çështje juridiko-penale mund të vij në konkludim se faktet me të cilat duhet te mbështet aktakuza duhet të jenë fakte vendimtare që e vërtetojnë në mënyrë të sigurt dhe pa dyshim ketë çështje penale e jo te bëhet një konstatim i supozuar se gjaja i akuzuari me date dhe në kohe të pacaktuar ka bërë ndërrimin e çelësit në hyrjen e derës ne lokalin afarist ku deri ne vitin 2013 kishte ushtruar veprimtarinë e tij afariste, është një aktakuzë e pa kuptimtë e pa përmbajtje për faktin se thuhet hynë në objektin e ndërmarrjes duke e zëvendësuar çelësin e derës së hyrjes me je dry tjetër, në ketë çështje edhe pse u dëgjua përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar ke shumë i pa qartë dhe konfuz po ashtu edhe dëshmitarja që u deklaruar se për asnjë moment nuk ka mundur të konstatoi apo të vërtetoi faktin se i akuzuari e kishte bërë ndërrimin e drynit për faktin se pas vendimit E.nr.516/2010 i njëjti asnjë dite të vetme nuk e kishte ushtruar veprimtarinë, pra nuk është vërtetuar me asnjë provë se e ka bërë ndërrimin e këtij dryni, apo që e ka ushtruar veprimtarin afariste ne lokal, apo e kanë penguar drejtë për se drejti te dëmtuarit në shfrytëzimin dhe posedimin e te

njëjtës apo e kanë penguar në procedurat e privatizimit të këtij lokali afarist. Andaj duke patur parasysh provat, rrethanat faktet e lartcekura konsideroi se veprimet e të akuzuarit tani Sh. H.nuk qëndrojnë se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet qofte nga natyra objektive apo subjektive e veprës për të cilën pandehet. Andaj nga këto të cekura gjykatës i propozoi që të akuzuarin Sh. H.ta liroi nga aktakuza me aktgjykim lirues”.

Fjala përfundimtare e të pandehurit

I pandehuri në fjalën përfundimtare deklaroi se: pajtohet me fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe nuk ka diçka tjetër për të shtuar.

Analiza dhe vlerësimi i provave

Gjykata me asnjë prove nuk ka mundur ta vërtetoj se i akuzuari te ketë kryer veprën penale cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve nga neni 200 par.1 te KPK-ës siç është cekur ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Faktet jokontestuese

- nuk është kontestues fakti se objekti ne fjalë që nga viti 2003 ka qenë nën menagjimin e APK-ës.
- Nuk është kontestues fakti se i pandehuri e ka pasur objektin ne fjalë ne shfrytëzim deri me dt.11,01,2013.
- Nuk është kontestues fakti se më dt. 11,01,2013 objekti në fjalë i është dorëzuar palës së dëmtuar dhe atë në bazë të aktvendimit E.nr.516/2010 te dt.11.01.2013 të marrë nga Gjykata Themelore Pejë dega Deçan.
- Nuk është kontestues fakti se i pandehuri e ka hequr aneksin e ndërtuar rreth objektit në fjalë dhe atë bë bazë te aktvendimit të drejtorit për inspeksion te Komunës së Deçanit nr. 10/2018 te dt.07.02.2018.
- Nuk është kontestues fakti se objekti ne fjalë është privatizuar ne vitin 2018.
- Nuk është kontestues fakti se-ja asnjë pengesë nuk e ka pasur nga i pandehuri gjatë procedurës së privatizimit.
- Nuk është kontestues fakti se asnjë pengese nuk e ka pasur lidhur me sendet qe kanë qen ne lokal ne momentin e përmbarrimit apo dorëzimit te lokalit e te cilat sende kanë qenë pronë e te dëmtuarit.

Këto fakte jokontestuese të cekura më lartë gjykata i ka quajtur jokontestuese sepse nuk janë kundërshtuar nga asnjëra palë pra nuk janë kundërshtuar as nga prokurori, as nga i pandehuri as nga i dëmtuari.

Faktet kontestuese

Gjatë shqyrtimit gjyqësorë për palët ka **qenë kontestuese** se i pandehuri a e ka ndërruar drynin e derës së hyrjes së lokalit – objektit e cila ishte nën menagjimin e deri në vitin 2018 përkatësisht deri në momentin kur është privatizuar.

Për të vërtetuar këtë fakt gjykata ka analizuar dhe vlerësuar provat personale dhe provat materiale të cilat i ka administruar gjatë shqyrtimit gjyqësorë, por nuk ka mundur të gjen asnjë element me të cilin do të vërtetohej se i pandehuri ta ketë ndërruar drynin e derës së hyrjes në objektin – lokalin “.....” në Deçan e cila ka qenë nën menagjimin e”.

Vlerësimi i provave personale

Gjykata ka analizuar dhe vlerësuar dëshminë e përfaqësuesit të N. Xh. nga e cila dëshmi është folur vetëm lidhur me faktet jokontestuese, andaj nga dëshmia e tij gjykata nuk ka mundur të gjen asnjë element me të cilin do të vërtetohet elementi i veprës penale cenim i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve nga neni 200 paragraf 1 të KPK-s.

Gjykata ka analizuar edhe dëshminë e dëshmitares H. K. e cila ka deklaruar se “me dt. 29.03.2018 se bashku me zyrtaren për kadastër kishin shkuar për të matur lokalit se sa metra katro i ka për të përgatitur dokumentacionin për të publikuar në tender për privatizim, mirëpo kur kishin shkuar nuk ju ishte hapur dryni i hyrjes së lokalit dhe menjëherë ishin kthyer për në Pejë ku kishin përpiluar një raport dhe e kaishin lajmëruar rastin ene polici”, ndërsa dëshmitarja nuk ka mundur të sqaron se a ishte dryni i ndërruar apo jo sepse ka thënë “ se nuk ka qenë në ditën kur i është vendosur dryni dhe i është dorëzuar lokali në fjale të dëmtuarës

Gjykata nga dëshmia e dëshmitares H. K. nuk ka mundur të vërtetojë asnjë element të veprës penale, sepse përveç thënies se nuk kanë mundur të hapin drynin, diçka tjetër nuk mund të vërtetohet nga dëshmia e saj.

Vlerësimi juridik i çështjes

- Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha provave personale dhe materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka nxjerrë përfundim se me asnjë provë nuk është provuar se i pandehuri ta ketë kryer veprën penale cenim i paprekshmërisë së banesave nga neni 200 par.1. të KPK-ës sepse nuk është vërtetuar me asnjë provë se i pandehuri të ketë ndërruar drynin e derës së hyrjes së lokalit i cili ka qenë nën menagjimin e-ës nga viti 2013 gjerë në vitin 2018.

Nuk është provuar se i pandehuri të ketë ndërruar drynin e derës së hyrjes së lokalit i cili ka qenë nën menagjimin e-ës nga viti 2013 gjerë në vitin 2018, sepse përveç dëshmisë së të dëshmitares H. K. e cila ka dëshmuar se ditën kritike me dt.29.03.2018 kur kanë shkuar te lokali nuk kanë mundur që ta hapin drynin, gjykatës nuk i është ofruar asnjë provë tjetër me të cilën do të vërtetohej se a kemi të bëjmë me të vërtetë me ndërrimin e ndrynit, nuk është ofruar asnjë provë se kemi të bëjmë me drynin e vendosur me dt.11.01.2013, nuk është ofruar asnjë

provë se dryni i cili është vendosur më dt.11.01.2013 dhe supozohet nga pala e dëmtuar se është dryni i njëjtë edhe me dt.29.03.2018 është i pa dëmtuar ne brendi të tij nga kalimi i kohës prej dt.11.01.2013, e gjerë me dt.29,03,2018.

- Gjykata duke u bazuar ne institutin juridik : “**IN DUBIO PRO REO - NE RAST MEDYSHJE NE FAVOR TE PANDEHURIT**”, ka vendosur dhe e ka liruar te akuzuarin nga akuza, sepse me asnjë prove nuk ka mundur te vërtetohet vepra penale e kanosjes nga neni 185 par.2 te KPK-ës, me te cilën ngarkohet .

-Gjykata ne rastet kur nuk vërtetohet ne tërësi me prova se i pandehuri ka kryer vepër penale e liron atë nga akuza sepse nuk mund te shpallet fajtor një i pandehur ne bazë te dyshimeve dhe mëdyshjeve.

- Nga sipërpërmendur e ne vështrim me dispozitën e nenit 364 par. 1. Nën par.1.3 te KPPK-ës, është vendosur si ne dispozitivin e aktgjykimit.

Në bazë te nenit 463 par.3 te KPPK-ës dëmtuara me seli në Prishtinë udhëzohet ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Në bazë nenit 454 paragraf 1 te KPPK-së i pandehuri lirohet nga shpenzimet e procedurës penale, ndërsa te njëjtat shpenzime do te paguhen nga mjetet buxhetore te gjykatës.

Duke u bazuar ne te lartcekurat u vendos si ne dispozitiv.

**GJYKATA KOMUNALE NË DEÇAN,
P. nr. 102/2018 te dt.18.12.2020**

Sekretarja juridike

Sabiha Hoxha

G j y q t a r i

Sulltan Dobraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet Gjykates Themelore Peje dega ne Deçan.